


# STUDIME HISTORIKE

QENDRA  
E STUDIMEVE  
ALBANOLOGJIKE

INSTITUTI  
I HISTORISË



2011 (3-4)  
VITI LXV(XLVIII)  
Tiranë, 2012

## REDAKSIA

Akademik BEQIR META (kryeredaktor),  
akademik asoc. MARENGLLEN VERLI (zëvendëskryeredaktor), dr. LEDIA DUSHKU  
(sekretare shkencore), (anëtarë) akademik KRISTAQ PRIFTI, prof. dr. FERIT DUKA,  
prof. dr. MUHARREM DEZHGIU, prof. dr. HAMIT KABA, prof. dr. GAZMEND  
SHPUZA, prof. dr. PËLLUMB XHUPI, prof. dr. ANA LALAJ, prof. dr. FATMIRA  
MUSAJ, prof. dr. ERIKETA KAMBO, prof. assoc. dr. DRITAN EGRO, dr. SONILA  
BOÇI, dr. EDMOND MALAJ

Përktheu në anglisht: Helian DEMIRI

Punoi në kompjuter dhe korrektoi: Meliha BALLA

Faqosja: Mirela MIHALI

© Copyright: Instituti i Historisë i Qendrës së Studimeve Albanologjike

Të gjitha të drejtat e rezervuara

Del çdo gjashtë muaj

---

Pronë letrare e Institutit të Historisë  
i Qendrës së Studimeve Albanologjike

---

Adresa: Rruga "Naim Frashëri", nr.7, Tiranë  
Telefax: 2225869

## PASQYRA E LËNDËS

		<i>Faqe</i>
Edmond MALAJ	Qytetet Dejë, Sardë dhe ipeshkvitë e tyre në Mesjetë	7
Pëllumb XHUFI	Përkime shqiptaro-malazeze në Mesjetë .....	31
Muin ÇAMI	Lufta çlirimtare e Vlorës dhe Eqrem bej Vlora me Faik Konicën .....	55
Beqir META	Marrëdhëniet shqiptaro-greke pas vendimit të Gjykatës së Hagës për çështjen e shkollave minoritare (prill-gusht 1935) .....	69
Muharrem DEZHGIU	Situata politike në Shqipëri (qershor – dhjetor 1943)	99
Ana LALAJ	Konferenca e Bujanit, 31 dhjetor 1943 - 2 janar 1944, një analizë e rivlerësuar .....	123
Eriketa KAMBO	Shkolla shqiptare në fillimet e “revolucionarizimit” (1966-1967) .....	143
<b>REFERATE E KUMTESA</b>		
Ledia DUSHKU	Kryengritja shqiptare antiosmane e vitit 1911 dhe dualizmi i politikës greke .....	165
Marenglen VERLI	Përgatitja e Kryengritjes së Malësisë së Madhe sipas dokumentacionit austro-hungarez .....	175
Hamit KABA	Baba Faja në vështrimin e disa burimeve britanike e amerikane .....	189
Marenglen KASMI	Aspekte të historiografisë gjermane për pushtimin gjerman të Shqipërisë (1943-1944) .....	197
<b>DOKUMENTE E MATERIALE</b>		
Fatjon BALLIU	Peshkopët e Krujës – dokumente të përkthyer nga latinishtja .....	205
<b>RECENSIONE</b>		
Memli KRASNIQI	Nathalie Clayer: “Në fillimet e nacionalizmit shqiptar: lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë”, Shtëpia botuese “Përpyjekja”, Tiranë 2009, f. 683 .....	249
Hamit KABA	Adem Mezini: “Shekulli XX”, Shtëpia botuese EXSTRA-R, Tiranë 2011, 349 f. ....	257

## NEKROLOGJI

Filip Liço .....	261
Dr. Zihni Haskaj .....	263
Prof dr. Muin Çami .....	265

## TABLE OF CONTENTS

		<i>Page</i>
Edmond MALAJ	The towns of Dejë and Sardë and their bishoprics in the Middle Ages .....	7
Pëllumb XHUFI	Albanian-Montenegrin commonalities during the Middle Ages .....	31
Muin ÇAMI	The liberation war of Vlora, Eqrem bey Vlora and Faik Konica .....	55
Beqir META	The Albanian-Greek relations after the Hague Court decision on the issue of minority schools (April-August 1935) .....	69
Muharrem DEZHGIU	The political situation in Albania (June – December 1943) .....	99
Ana LALAJ	Bujan Conference, 31 December 1943 - 2 January 1944, a reviewed analysis .....	123
Eriketa KAMBO	The beginnings of “revolutionizing” the Albanian school system (1966-1967) .....	143
<b>PAPERS AND COMMUNICATIONS</b>		
Ledia DUSHKU	The Albanian anti-ottoman uprising of 1911 and the dualism of the Greek policy .....	165
Marenglen VERLI	The preparations for the uprising in Malësia e Madhe according to Austro-Hungarian documents ...	175
Hamit KABA	Baba Faja from the viewpoint of some British and American sources .....	189
Marenglen KASMI	Aspects of the German historiography on the German occupation of Albania (1943-1944) .....	197
<b>DOCUMENTS AND MATERIALS</b>		
Fatjon BALLIU	The Bishops of Kruja – documents translated from Latin to Albanian .....	205
<b>REVIEWS</b>		
Memli KRASNIQI	Nathalie Clayer: “The beginnings of the Albanian nationalism: the birth of a Muslim nation in Europe Publishing house “Përpjekja”, Tiranë 2009, 683 f. ...	249
Hamit KABA	Adem Mezini: “The Twentieth Century”, Publishing House EXSTRA-R, Tiranë 2011, 349 f. ....	257

## NECROLOGY

Filip Liço .....	261
Dr. Zihni Haskaj .....	263
Prof dr. Muin Çami .....	265

**EDMOND MALAJ****QYTETET DEJË, SARDË DHE IPESHKVITË E TYRE  
NË MESJETË**

Në këtë artikull do t'i hidhet një vështrim i shkurtër historisë mesjetare të Dejës dhe Sardës, dy qyteteve që në Mesjetë ndodheshin në afërsi të Shkodrës por që sot nuk ekzistojnë më, megjithëse dikur ato ishin qendra urbane të mirëfillta, me të gjithë komponentët që përbënin një qytet mesjetar. Këto dy qendra ishin ipeshkvi me kisha të shumta dhe me një zhvillim zëjtar të admirueshëm ekonomik, kulturor dhe bile Deja kishte edhe një doganë, ngaqë ndodhej në një pikë ku takoheshin rruga e Shkodrës me atë të Lezhës, prej aty pastaj shkohej më tej për në Prizren. Pra, një pikë transiti mallrash dhe njerëzish që padyshim luanin një rol të rëndësishëm në zhvillimin e qytetit. Përveç të dhënave të reja për këto dy qytete, të sjella në këtë artikull, për të cilat jam bazuar tek punimet e Konstantin Jireček, Milan Shuflaj dhe të Oliver Jens Shmit, një kontribut tjetër i ri këtu (në krahasim me artikujt e tjerë të botuar më parë për këto dy qytete) janë edhe informacionet përmbledhëse në lidhje me ipeshkvitë e këtyre dy qendrave dhe ipeshkëvit e tyre gjatë Mesjetës. Për nxjerrjen e këtyre të dhënave jam përqendruar kryesisht tek Vepra monumentale e Daniele Falatos dhe Jakobo Koletos "Illyricum Sacrum", vëllimi VII.

**Qyteti mesjetar i Dejës**

Në kuadër të studimit tim "Shkodra në mesjetë" një ditë shkova të vizitoj dhe rrënojat e qytetit të dikurshëm të Dejës (*Dagno*) që ndodhet jo shumë larg Shkodrës dhe që shtrihet mbi një kodër në formë kambane,<sup>1</sup> pranë lumit Drin. Nën këtë kodër shtrihet lokaliteti "Vau i Dejës, dikur një fshat i vogël"<sup>2</sup>, porse sot është zmadhuar dhe si njësi administrative njihet si qytet. Të ngjitesh sipër tek rrënojat e Dejës nuk është e thjeshtë, pasi nuk ka asnjë rrugë që të çon atje dhe për t'i vizituar ato m'u desh të

---

<sup>1</sup> Konstantin Jireček, "Skutari und sein Gebiet im Mittelalter", në *Illyrisch-Albanische Forschungen*. Unter Mitwirkung von Professor Dr. Konstantin Jireček [e të tjerë]. Zusammengestellt von Dr. Ludwig von Thallóczy. I. Band. Mit einer Landkarte. München/Leipzig: Duncker und Humblot 1916, f. 114.

<sup>2</sup> Po aty.

kaloja rrugë pa rrugë, përmes shkurrësh dhe shkëmbinjsh që ta bëjnë ngjitjen shumë të vështirë. Pra rruga e qytetit të dikurshëm sot nuk




Fig. 1 Kisha Shën Mëria e Vaut të Dejës, rrënuar në vitin 1967. Foto marrë nga Muzeu i Kalasë Rozafa Shkodër.

ekziston më dhe nuk munda të konstatoj as gjurmët e saj, por i ndodhur sipër tek këto rrënoja, po të shohësh poshtë në drejtim të kishës së re të Shën Mërisë duken disa gjurmë që i ngjajnë atyre të një rruge të dikurshme kalldrëmi.

Deja ndodhej në Mesjetë në një pikë transite me rëndësi sepse, sipas Jireçekut,

në këtë vend ishte edhe kalimi i vjetër mbi lumin Drin me barka të mëdha, të cilat tek të dhënat raguzane në vitin 1377 quhen “pareço” dhe “ladia”, dhe po këtu bashkoheshin rrugët nga Shkodra dhe Lezha dhe vazhdonin më tej si një rrugë e vetme në drejtim të lindjes, kah Prizreni.<sup>3</sup>

Kështjella është e njohur mirë nga dokumentet e shek. XIV dhe XV dhe quhet në latinisht *Dagnum (mercatum Dani, de Dano, de Dagno* = Tregu i Dejës – E. M.), në italisht *Dagno* dhe në serbisht *Danj*.<sup>4</sup>

Në vitin 1326 mbreti serb Stefan Uroshi III u lëshoi raguzanëve një privilegj tregtie (*na Dani*), dhe rreth 22 vjet më vonë pra në vitin 1348 cari Stefan Dushan ia fali kishën që ndodhet nën kështjellë manastirit të tij (Manastiri i Kryeengjëllit) në Prizren: “*kishën në Dejë, pra kishën e Zojës së bashku me njerëzit dhe me trojet dhe me fshatrat Prapratnica dhe Lonçari*”.<sup>5</sup> Në kohën e sundimit të carit Urosh në vitin 1348 paraqitet në Dejë një ipeshkëv latin, nën juridiksionin e kryeipeshkëvit të Tivarit<sup>6</sup>;

<sup>3</sup> Po aty, f. 115.

<sup>4</sup> Po aty.

<sup>5</sup> Po aty. “*Die Kirche in Danj die Heilige Mutte Gottes mit Leuten und Grundstücken und mit dem Dorf Prapratnica und dem Dorf Lonçari. (Urk. im Glasnik 15, 304)*”.

<sup>6</sup> Po aty.

tek Farlati seria e këtyre ipeshkëve, siç do ta shohim edhe më poshtë arrin deri në vitin 1520.

Deja kishte edhe një zyrë doganore (*carina na Dani, Danju*), e cila përmendet shpesh herë në periudhën e Balshajve, si për shembull në një dokument të vitit 1368 përmendën raguzanë që po mundoheshin të nxirrnin privilegje nga Balshajt dhe të liroheshin nga Dogana e Dejës, dhe për këtë shkuan e u takuan me Gjergj I Balshën i cili ndodhej në breg të Matit me trupat e tij kundër Karl Topisë.<sup>7</sup>

Gjergj Strazimiri u dorëzoi venecianëve së bashku me Shkodrën edhe Dejën, por para këtij dorëzimi këtë vend, së bashku me kështjellën, e kishte nën zotërim fisniku Koja Zakaria (Coya Zaccaria), i cili ndër shkresa e quante veten “*Dominus Sabatensis et Dagnensis*” (Zot i Sapës dhe i Danjës – E. M.).<sup>8</sup> Si ndërmjetës



Fig. 2. Rrënojat e qytetit të Dejës Foto: E. Malaj

pranë Venedikut për Koja Zakarinë ishte fra Nikolla nga Shkodra.<sup>9</sup>

Rreth vitit 1431 për disa kohë këtu pati edhe një qeveritar turk (*qefali*).<sup>10</sup> Më në fund, në vitin 1444 zonja Bolja ose Boja, e bija e Kojës ua dorëzoi venecianëve kështjellën e Dejës me shtatë topa dhe bashkë me të edhe kështjellën e Shatit, plus vende të tjera përreth.<sup>11</sup> Për këtë dorëzim ajo, sipas marrëveshjes që kishte bërë me Venedikun, duhej të merrte nga qeveritari venedikas i Shkodrës 10 dukatë në muaj, “*mirëpo ky i fundit*

<sup>7</sup> Luan Malltezi, *Qytetet e Bregdetit Shqiptar gjatë Sundimit Venedikas 1392-1478 (Aspekte të jetës së tyre)*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1988, f. 49.

<sup>8</sup> K. Jireček, “Skutari und sein...”, f. 115.

<sup>9</sup> Giuseppe (Zef) Valentini, *Kontribute në kronologjinë e historisë së Shqipërisë 1060-1560*, (Pa vend botimi): “Plejad”, 2010, f. 204.

<sup>10</sup> K. Jireček, “Skutari und sein ...”, f. 115.

<sup>11</sup> Po aty.




Fig. 3. Rrënojat e qytetit të Dejës Foto: E. Malaj

nuk ua jepte shumën e të hollave në dukate, por në groshë, duke ua llogaritur dukatin 40 groshë në një kohë kur kursi i dukatit ishte 45 groshë”.<sup>12</sup>

Pas këtyre ngjarjeve, në vitin 1447 Skënderbeu ua mori me forcë Dejën venecianëve, por ua ktheu përsëri

në vitin 1448.<sup>13</sup> Aty u bë një traktat paqeje që i dha fund luftës ndërmjet tyre për çështjen e Dejës.<sup>14</sup> Për këtë kthim të kështjellës venecianëve, Skënderbeu duhet të merrte prej Sinjorisë një provizion prej 1400 dukatesh, në bazë të traktatit të paqes së lartpërmendur dhe duke pasur parasysh që venedikasit mund ta mashtronin, ai i pat thënë ambasadorit të tij: “Hap sytë për dukatët që më japin me 42 groshë, kurse unë dua të mi japin me 48 groshë”.<sup>15</sup> Dhe kjo frikë e Skënderbeut në lidhje me mashtrimin duket se ishte bërë realitet pasi më 8 korrik të vitit 1457 edhe ai bën ankesë në senat në lidhje me shumën e lartpërmendur të 1400 dukatëve.<sup>16</sup>

Në vitin 1452 (Sipas Valentinit, nga një dokument i datës 10.4.1452) mësojmë që në Kështjellë të Dejës shkrepin rrufe të forta dhe si rrjedhojë e shkatërrimeve komuniteti që i detyruar të bënte meremetime.<sup>17</sup> Por mesa duket (sipas Shuflajt) shkatërrimet që ndodhën atë vit nga rrufetë

<sup>12</sup> L. Malltezi, *Qytetet e Bregdetit ...*, f. 183 (për këtë arsye ajo dhe nëna e saj bëjnë një ankesë në senatin venedikas, më datë 12 maj të vitit 1450).

<sup>13</sup> K. Jireček, “Skutari und sein ...”, f. 115.

<sup>14</sup> L. Malltezi, *Qytetet e Bregdetit ...*, f. 183.

<sup>15</sup> *Po aty*. (Malltezi citon nga: ASV. Avog. Com. Raspe 6/26v-27v.)

<sup>16</sup> *Po aty*.

<sup>17</sup> G. Valentini, *Kontribute në kronologjinë...*, f. 166.

qenë ndoshta njëri ndër shkaqet që qyteti ra dhe u zhduk përfundimisht.<sup>18</sup> Në një dokument të vitit 1610 bëhet fjalë për mure tashmë të shkatërruara nga koha e Skënderbeut,<sup>19</sup> porse në lidhje me sulmin e Skënderbeut si faktor i rënies së qytetit, mbetet të hulumtohet akoma.

Dukagjinasi ua morën Dejën venedikasve në vitin 1456, porse në vitin 1458 Lekë Dukagjini me vëllezër ua ktheu atë përsëri organeve venedikase.<sup>20</sup>

Ndërkaq në vitin 1456 zonja Boja ankohej se Papa ia paska dorëzuar “kape-lën e Shën Marisë nën Dejë” (*capellam*




Fig. 4. Rrënojat e qytetit të Dejës

Foto: E. Malaj

*Sancte Marie subtus Dagnum*) një prifti katolik, por Republika e Venedikut iu përgjigj Bojës, që ajo (republika) nuk mund të shfuqizonte bulat papnore, dhe kështu zonja fisnike duhej të ankohej vetë tek Papa.<sup>21</sup>

Krahina përreth Dejës në atë kohë ishte e kultivuar mirë, aty ishte plot me fshatra dhe me vreshta të reja dhe të vjetra.<sup>22</sup> Pranë fshatit Mazrek, më tej në drejtim të lindjes, në bregun e djathtë të Drinit ndodhej një kishë e gjatë 27 hapa, me kullë, e cila i përket mbetjeve të një manastiri të vjetër dhe një mbishkrim aty përmend “*rex Vros*” (pra mbretin Uros) dhe abatin (*abas*) e manastirit “*cum universo suo clero*” (me të gjithë klerin e

<sup>18</sup> Milan von Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens hauptsächlich während des Mittelalters*. Vorgelegt in der Sitzung am 24. April 1918. Kommissions-Verleger der Akademie der Wissenschaften in Wien. Wien/Leipzig: Hölder-Pichler-Tempsky A.-G. 1924, f. 26.

<sup>19</sup> Po aty, f. 26, “1610, vestige della citta de Dagna gia ruinate de Scanderbegh”.

<sup>20</sup> K. Jireček, “Skutari und sein ...”, f. 115.

<sup>21</sup> Po aty, f. 116.

<sup>22</sup> Po aty.

tij)<sup>23</sup>. Ndërtesën e kësaj kishe e përshkruajnë Jastrebovi, ndërsa Ippeni e quan atë “*Kisha e Shën Kollit*” të Shatit.<sup>24</sup> Deja kishte edhe “statutin e saj”, të përbërë prej mbi 500 nyjash, “si një prej statuteve më të plotë të gjithë qyteteve të vijës bregdetare adriatike, prej Vlorës, deri në Piran e Zadar”<sup>25</sup>. Ky statut ndodhet, sipas Sinanit, në Arkivin Shtetëror Kroat, dhe i përket fondit personal “Milan Shuflaj”.<sup>26</sup> Ne pra akoma edhe sot nuk e njohim përmbajtjen e këtij statuti.

Deja mesa duket ra në duar të Turqve në vitin 1474 dhe për këtë ishte shkaktar Pjetër Salamori, i cili pastaj u dënua që kishte dorëzuar këtë qytet, dhe sipas Zef Valentinit dokumenti që flet për këtë është i datës 21. 6. 1474.<sup>27</sup> Qyteti u shkatërrua përfundimisht nga forcat e Sulejman Pashës, i cili nuk kishte mundur të pushtonte Shkodrën dhe ishte drejtuar drejt Prizrenit dhe osmanët shkatërruan edhe kishën e lartpërmendur të Zonjës në Dejë.<sup>28</sup> Kjo pra ishte një histori e shkurtër e qytetit të Dejës, kurse përsa i përket vendit përreth Dejës, që quhej *Rogamania*, po japim vetëm fshatrat që përmenden edhe në dokumente rreth vitit 1460: La Virda (tani Vjerdha), Lissani (tani Lisna), Dodice (tani Dodej), Medoia (tani Mjeda).<sup>29</sup>

### **Ipeshkvia e Dejës dhe kishat e saj**

Tani le t’u hedhim një vështrim kishave në Dejë dhe përreth saj, të cilat kanë ekzistuar në Mesjetë. Në fshatin e Vaut të Dejës ndodhej dikur një kishë dedikuar Shën Mërisë.<sup>30</sup> Kjo kishë ishte një ndërtesë e fortë me kupolë të lartë, por, sipas Jireçekut, për fat të keq, afresket e saj ishin të dëmtuara shumë: ato më të rejat ishin të pikturuara sipër të vjetrave dhe mbishkrimet e tyre ishin pjesërisht latinisht, dhe pjesërisht greqisht.<sup>31</sup> Në këtë kishë thuhet, se vuri kurorë heroji ynë kombëtar Gjergj Kastrioti

<sup>23</sup> Po aty.

<sup>24</sup> Po aty.

<sup>25</sup> Shaban Sinani, “Dr. Milan Shuflaj (Šufflay), Acta Albaniae III”, në *Perla*, nr. 3, 2002, f. 33.

<sup>26</sup> Po aty.

<sup>27</sup> G. Valentini, *Kontribute në kronologjinë...*, f. 167.

<sup>28</sup> Lulëzim Lajçi, *Shkodra në shekullin e XV*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë: 1997, f. 121.

<sup>29</sup> K. Jireček, “Skutari und sein ...”, f. 121.

<sup>30</sup> Po aty, f. 114.

<sup>31</sup> Po aty, f. 115.

Skënderbeu me Donika Kastriotin,<sup>32</sup> por duhet të theksoj këtu, në lidhje me martesën e Skënderbeut ka edhe një kishë tjetër në të cilën sipas gojëdhënave popullore thuhet se ata kanë vënë kurorë. Kjo është kisha “Lindja e Shën Mërisë” në Ardenicë.<sup>33</sup>



Fig. 5. Kisha e Shën Mërisë e rindërtuar

Foto: E. Malaj

Rreth kishës së Shën Mërisë së Dejës na jep të dhëna edhe Frang Bardhi në relacionin

e tij të vitit 1641, ku thotë: “*Famullia e shtatë asht kisha e të Lemit të Shën Mërisë nën Dejë, e ndërtueme në luginën e Malit të Dejës, një e gjuajtme shigjete larg prej Drinit. Ajo kisha e të lemit të Zojës asht e vogël, por me ndërtim shumë të bukur, e gjithë në gur katror të latuem, me dysheme e me tavan prej dërrasash dhe asht e mbulueme me tjegulla; mendohet se, n’atë mënyrë si sodit ka qenë ndërtue prej Helenës frënge, grues së mbretit Stefan të Serbisë. Në Zadrimë nuk ka kishë të bukur si këtë.*”<sup>34</sup>

Kjo kishë i përkiste shek. XIII.<sup>35</sup> Ajo ishte monument i çmueshëm i historisë shqiptare dhe u shkatërrua në vitin 1967 nga sekretari i

<sup>32</sup> Markus W. E. Peters, *Die Geschichte der Katholischen Kirche in Albanien seit der Pariser Friedenskonferenz 1919/20 bis zur Pastoralvisite Papst Johannes Pauls II. im Jahre 1993*. Bonn. Phil. Diss. Katholisch-Theologische Fakultät der Rheinischen Friedrich-Wilhelm-Universität 2001, f. 191-192.

<sup>33</sup> *Materiale dhe Dokumente për Shqipërinë Juglindore të shek. XVIII- fillimi i shek. XX. (Kodiku i Korçës dhe i Selasfortit)*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, II, Tiranë: 1981, f. 137.

<sup>34</sup> Tonin Çobani, *Frang Bardhi dhe Relacionet e tij*, “Relacioni më 10 prill 1641”, Zagreb: Misioni Katolik Shqiptar në Kroaci, 2006, f. 142-143.

<sup>35</sup> Dhorka Dharmo, “Kisha e Shën Mërisë në Vaun e Dejës”, në *Studime historike*, Nr. 3, Tiranë: 1964, f. 65.

atëhershëm i partisë, komunisti Fadil Ymeri, në kuadrin e revolucionit kulturor kinez dhe, sipas studiuesit gjerman Markus Peters, ajo ishte e vetmja kishë gotike që kishte mbetur në truallin e Shqipërisë.<sup>36</sup> Por, përsa i përket stilit të ndërtimit të saj, Dhorka Dhamo na jep të dhëna krejt të ndryshme. Sipas saj kjo kishë “është e ndërtuar në stil romanik që depërtoi në veri të vendit tonë nga qendrat bregdetare italiane e kryesisht nga krahina e Markës. Këtëj e pati burimin e tij ky stil edhe për monumentet e tjera të shkollës së Rashës, si paraardhëse e të cilave konsiderohet kisha e Shirqit pranë Shkodrës.”<sup>37</sup>

Krahas kishës së moçme ndodhej edhe një kishë tjetër e ndërtuar në vitin 1926 nga Dom Nikoll Seldia, po sipas sipas modelit të saj në një stil pseudoromanik, por që ishte shumë më e madhe se kisha e moçme.<sup>38</sup> Kisha kishte një portë të vjetër druri, e cila sipas gojëdhënave u hoq nga një vezir i Shkodrës dhe u dërgua ose në kala ose në bezistenin e qytetit që ndodhej dikur poshtë kalasë Rozafat.<sup>39</sup> Për këtë kishë ka edhe një gojëdhënë që lidhet edhe me portën e saj të vjetër, sepse para se të hapej ajo portë kisha kishte qenë e mbyllur dhe nuk kishte funksionuar, pasi “në të ishin fshehur lugjetnit, njerëz të ardhur nga lugjet, por një ditë lugjetnit i vrau një trim dhe prej asaj dite kisha u hap, por këmbanët e saj nuk ranë për shumë kohë, për të plotësuar kërkesën e trimit që ishte mysliman.”<sup>40</sup> Në vend të saj është ndërtuar kisha e re e Lindjes së Shën Marisë (fig. 5).

Sipas artistit korçar Vladimir Kaçaku, që në kohën e shkatërrimit të kishës, kur ishte student, një ditë pas hedhjes në erë të saj, kishte qenë atje, së bashku me pedagogun e tij Sali Shijaku dhe me studentë të tjerë. Sali Shijaku kishte mundur të heqë një pikturë murale dhe ta marrë atë me vete, duke e shpëtuar atë nga shkatërrimi përfundimtar.<sup>41</sup>

Me Skënderbeun duket se lidhet edhe një kishë tjetër, mbi malin e Shën Markut, ku ndodhen edhe rrënojat e qytetit. Kjo kishë e rindërtuar është *Kisha e Zojës së Dêjës*, e cila, sipas gojëdhënës u ndërtua nga ai,

<sup>36</sup> M. Peters, *Die Geschichte der Katholischen...*, f. 191-192.

<sup>37</sup> Dh. Dhamo, “Kisha e Shën Mërisë ...”, f. 65.

<sup>38</sup> Po aty, f. 49.

<sup>39</sup> Po aty, f. 51.

<sup>40</sup> Po aty, f. 52.

<sup>41</sup> E dhënë e marrë nga intervista e bërë Vladimir Kaçakut në Korçë nga vetë autori Edmond Malaj në gusht të vitit 2011.

pas një fitoreje që arriti kundër venedikasve.<sup>42</sup> Rrënojat e kësaj kishe nuk munda t'i identifikojë, midis rrënojave të tjera të qytetit.

Një kishë tjetër e vjetër e këtij qyteti ka qenë edhe Kapela e Shën Markut\* e cila, mesa duket, dikur ndodhej brenda mureve të qytetit. Këtë kapelë e përmend edhe Frang Bardhi në relacionin e tij të vitit 1641, për të cilën thotë se ishte e madhe dhe e meremetuar.<sup>43</sup> Gjithashtu e meremetuar ajo ishte edhe kohën e sotme dhe këtë e konstatova në vizitën që bëra në Dejë, më 12 korrik 2011. Dikur kjo kishë mbi portën e saj, kishte pasur të gdhendur në gur datën 1465 dhe sipas Theofan Popës, kjo datë, me shifra arabe, mund të ishte e një kohe të vonë dhe ndoshta regjistron ndonjë gojëdhënë më të lashtë mbi kohën e ndërtimit të kishës.<sup>44</sup> Në afërsi të Dejës kishte edhe një manastir dedikuar Shën Sofisë.<sup>45</sup> Mbi këtë manastir hëpërhë nuk dimë asgjë, përveç faktit që një kanonik i saj në vitin 1434 bëhet legat i papës për të gjithë Ballkanin Perëndimor.<sup>46</sup> Në përgjithësi mund të themi që në Dejë kishte një farë përqendrimi dhe ndikimi Urdhri Domenikan, dhe kjo del në mënyrë indirekte nga përkatësia e ipeshkëve, pasi një numër i konsideruar i përkiste këtij urdhri, gjë që do ta shohim nga vargu e ipeshkëve të Dejës që jepet në vazhdim.

### Vargu i ipeshkëve të Dejës

1361 Donati, Paracha. I (*Donatus Episcopus Daynensis I.*)

Donati u bë ipeshkëv i Dejës në vitin 1361 por nuk e dimë origjinën e tij, dhe përse i përket përkatësisë së tij si klerik duket se ka qenë ose i urdhrit françeskan, ose i atij dominikan, por nuk përjashtohet mundësia

<sup>42</sup> Merita Kazazi, *Shurdhahu*. Marrë nga interneti:

<http://www.qarkushkoder.org/dw/turist/shurdhahu.pdf> (11.07.2010).

\* Sipas Dhorka Dhamos, është kisha e Shën Markut, ajo që u ndërtua nga Skënderbeu. Dh. Dhamo, "Kisha e Shën Mërisë...", f. 53.

<sup>43</sup> T. Çobani, *Frang Bardhi dhe Relacionet...*, f. 145-147.

<sup>44</sup> Theofan Popa, *Mbishkrimet të kishave në Shqipëri*, Tiranë: "Shkenca", 1999, f. 331.

<sup>45</sup> Oliver Jens Schmitt, *Das venezianische Albanien (1392-1479)*, München: Oldenburg 2001, f. 574. (Südosteuropäische Arbeiten 110. Für Südost-Institut München Hrsg. v. Edgar Hösch und Karl Nehring.) f. 133-182.

<sup>46</sup> *Po aty*, f. 574.

që mund të ketë bërë pjesë edhe tek ndonjë grup tjetër.<sup>47</sup> Në kohën e këtij ipeshkvi, në vitin 1394, Ipeshkvia e Dejës, e cila kërcënohej të zhdukej u vu nën mbrojtjen venedikase.<sup>48</sup> Kjo ndodhi pasi në postin e arqipeshkvit të Durrësit, nga kapiteli i kësaj arqipeshkëvie u zgjodh një klerik që mbante krahun e Venedikut.<sup>49</sup>

1397 Gjoni, Ipeshkëv i Dejës II. (*Johannes Epicopus Dainensis II*)

Sipas Farlatit, Gjoni bënte pjesë në konfesionin e predikatoreve dhe u bë ipeshkëv i Dejës më 16 nëntor të vitit 1397 nga Papa Bonifacius IX dhe këtë e mësojmë nga një diplomë të lëshuar po nga i njëjti papë, që e emëron Johan Blasion ipeshkëv të Dejës.<sup>50</sup>

1401 Vlashi Ipeshkëv i Dejës (*Blasius Episcopus Daynensis III*)

Në vitin 1401 bëhet ipeshkëv i Dejës Blasius (Vlashi) nga Zagrebi, ai ishte i urdhrit domenikan dhe i jepet titulli ipeshkëv nga papa Bonifacius, dhe shquhej si njeri me moral të larte, me dije të thella në shkencë dhe i zellshëm në fe.<sup>51</sup>

Andrea Ipeshkëv i Dejës (*Andreas Episcopus Daynensis IV*)

Andrea, më përpara kishte qenë ipeshkëv i Sardës, dhe u bë ipeshkëv i Dejës në vend të Johannes Palombos. Pasi ndenji atje për disa kohë me urdhër të papës Gjoni XXIII bëhet ipeshkëv i Dejës, por viti kur mori këtë titull nuk dihet. Qëndroi si ipeshkëv i Dejës deri në vitin 1412, dhe iku prej aty po me urdhër të papës Gjoni XXIII për t'u bërë ipeshkëv i Krujës (*Ecclesia Albanensis*).<sup>52</sup>

1414 Prebislavi Ipeshkëv i Dejës (*Prebislaus Episcopus Daynensis V*)

Prebislavi ishte kanonik i Shën Sepulcrit (Varrit të Shenjtë) dhe klerik i urdhrit augustinian. Më përpara kishte qenë epror i kuvendit të Shën

<sup>47</sup> "...nam vocabulum fratris Donato adjectum indicat sane, cujusquam aut Franciscanae, aut Dominicanæ, alteriusve familiæ alumnum fuisse", *Illyrici Sacri*, Tomus Septimus, Ecclesia Diocletiana, Antibarensis, Dyrrhachiensis et Sirmiensis, cum eorum suffraganeis. Auctore Daniele Farlato, Presbytero Societatis Jesu, et Jacobo Coletto olim ejusdem Societatis alumno. Venetiis, MDCCCXVII. Aput Sebastianum Coleti. Superiorem permissu ac privilegio. (Botim i dytë. Prishtinë: Arbi 2004.), f. 230.

<sup>48</sup> O. Schmitt, *Das venezianische Albanien...*, f. 572.

<sup>49</sup> *Po aty*.

<sup>50</sup> "Extat diploma Bonifacii IX. paullo post describendum, in quo Pontifex Danensem vocat Ecclesiam illam, in cujus Sedem Episcopalem Joanni Blasium subrogavit..." D. Farlati, *Illyricum Sacrum* 7, f. 230.

<sup>51</sup> *Po aty*, f. 231.

<sup>52</sup> *Po aty*, f. 231, 198.

Gjonit në Gnesman (qytet arqipeshvnor) të Polonisë. Titullin e ipeshkvit të Dejës ai e mbajti për gjashtë vjet pra deri në vitin 1420.<sup>53</sup>

1420 Vlasi Ipeshkëv i Dejës (*Balsius II. Episcopus Daynensis VI*)

Vlasi ishte i urdhrit domenikan dhe u bë ipeshkëv i Dejës në vitin 1420 nga papa Martin V. Vlasi qe dy vjet ipeshkëv i Dejës deri sa vdiq.<sup>54</sup> Në lidhje me origjinën e tij nuk mund të themi hëpërhë asgjë, pasi nuk kemi asnjë të dhënë.

1422 Gjoni II ipeshkëv i Dejës (*Joannes II Episcopus Daynensis VII*)

Gjoni është i regjistruar në regjistrat konsistoriale si ipeshkëv i Dejës më 15 prill të vitit 1422, por në lidhje me të nuk ka asnjë të dhënë tjetër.<sup>55</sup>

1428 Pjetër Matia, Ipeshkëv i Dejës (*Petrus Mathias Episcopus Daynensis VIII*) Pjetri, i cili ishte edhe kanonik i kishës së Sardës, u bë më 6 gusht të vitit 1428 njëkohësisht edhe ipeshkëv i Dejës nga papa Martini V, duke i lidhur kështu të dyja kishat bashkë.<sup>56</sup>

Gjoni III, ipeshkëv i Dejës (*Johannes III. Episcopus IX*)

Si ipeshkëv i Dejës ai njihet vetëm nga nënshkrimet e një koncili të zhvilluar Firence në vitin 1439, ndër të cilat gjendet edhe mbishkrimi i tij, por më tepër për të nuk ka asnjë të dhënë tjetër.<sup>57</sup>

1444 Shtjefni, Ipeshkëv i Dejës (*Stephanus Episcopus Daynensis X*)

Shtjefni i ishte i fisit të Dukagjinit, që ishin edhe ndër prijësit mesjetarë shqiptarë, në principatën (sipas Farlatit) e të cilëve ndodhej Pulti, por edhe Deja. Para se të bëhej ipeshkëv ai kishte qenë arqidiakon i Kishës së Shkodrës (*Ecclesia Scodrensis*) dhe kur turqit po kërcënonin tashmë Shqipërinë, papa Eugjeni IV më 6 qershor të vitit 1444e bën Shtjefnin ipeshkëv të Dejës dhe të Sardës.<sup>58</sup>

1456 Godefridi, Ipeshkëv i Dejës (*Godefridus Episcopus Daynensis XI*)

<sup>53</sup> Po aty, f. 231.

<sup>54</sup> Po aty.

<sup>55</sup> Po aty.

<sup>56</sup> "Hunc Martinus V. cum Daynensi Ecclesiam Sardanensem vel Sardenensem conjunxisset, Rectrorem utrumque Ecclesiae praefecit. An. 1428. VI Kal. Augusti providit Ecclesiae Sardanen. et Daynen. ivicem uniitsvacantibus per obitum de persona Petri Matthiae Canonoci dictae Ecclesiae Sardanen. ecc." Po aty.

<sup>57</sup> Po aty, f. 231-232.

<sup>58</sup> Po aty, f. 232.

Emri i tij i plotë ishte Godefridus Greverayus, ai ishte me origjinë nga Belgjika dhe i përkiste urdhrit karmelitan, në të cilin kishte hyrë në qytetin e tij të lindjes *Geldrien (!)*. Ai vdiq në Bruksel më 17 janar 1504, dhe u varros po aty në varrezat karmelitane.<sup>59</sup>

1520 Guljelmi ipeshkëv i Dejës (Guillelmus Episcopus Daynensis XII) Emri i tij i plotë ishte Guillelums Agieton dhe ishte galez për nga kombësia. Ai i përkiste urdhrit domenikan. Ky ishte edhe ipeshkvi i fundit i Dejës, pasi më pas ajo nuk figuron më si ipeshkvi më vete, pasi bashkohet me ipeshkvinë e Sardës dhe të Sapës dhe të tri kishat së bashku formojnë Ipeshkvinë e Sapës,<sup>60</sup> e cila ekziston edhe sot e kësaj dite.

Pasi i hodhëm një vështrim të shkurtër qytetit dhe ipeshkvisë së Dejës po vazhdoj më tej, me përshkrimin e një qyteti tjetër mesjetar, atë të Sardës.\*

### Qyteti i Sardës dhe ipeshkvia e saj

Përballë Dejës, në bregun e majtë të Drinit, mbi një ishull shkëmbor 130 m mbi nivelin e detit, rreth 8 km larg Shkodrës, gjenden rrënojat<sup>61</sup> e një qyteti me kështjellë.<sup>62</sup> Kjo është Sarda që tek shkrimtarët klasikë quhej *Sarda*, *Sardum*, apo “*greq. Σαρδος/Πολις/Ιλλυριας*” (pra Sardos, qytet i Ilirisë), apo në dokumentet sllave edhe me emërtimin “*Sardoniki*

<sup>59</sup> “[...] fuisse nimmirum natione Belgam, patria Geldriensis et alumum Conventus Carmelit. ejusdem civitatis, Episcopum Dagniensem titularem die 15. Martii an. 1456; et subditur, obiisse 1504. die 17 Januarii, Bruxellis, ibisque sepultum in choro Carmelitarum.” Po aty.

<sup>60</sup> “Caeterim jam inde a seculo decimo quinto Daynensis Ecclesia cum Sardensi conjuncta a Marino V. uti diximus, suo semper Eepiscopo caruit; cumque tres ecclesiae Sappatensin, Sadensis & Daynensis in unam coaluissent, unus deinde, idemque episcopus praepositus fuit, qui administrationem carum susciperet.” Po aty.

\* **Shënim:** Për fat të keq Sardën nuk munda ta vizitoj personalisht, pasi është në ishull, dhe pa varkë nuk mund të kalohet matanë.

<sup>61</sup> Fig. 7: Pamje nga rrënojat e Sardës. Marrë nga M. Kazazi: Shurdhahu, *bur. i për. interneti*.

<sup>62</sup> Hëna Spahiu, Damian Komata, “Shurdhahu – Sarda Qytet i fortifikuar mesjetar. Rezultatet e gërmimeve të viteve 1967-1970”, në: *Iliria. Studime dhe materiale arkeologjike*, Tiranë: 3/1974, f. 257.

*Grad*” (qyteti i Sardës), kurse qytetarët e Sardës njiheshin si “lat. *Cives Sardeni*” ose “greq. *Οι πολται Σαρδινοι*” (pra qytetarët e Sardës).<sup>63</sup>

Dikur vendi ku ndodhet Sarda ishte gadishull<sup>64</sup> pra mund të arrihej edhe nëpërmjet tokës por sot, qysh me ndërtimin e hidrocentralit të Vaut të Dejës, kodra u kthye në një ishull dhe mund të shkohet vetëm me lundër.<sup>65</sup>




Fig. 6. Pamje nga rrënojat e Sardës

Sipas gojëdhënave popullore në kohët e vjetra në Sardë kishe edhe një urë që lidhte qytetin me anën

tjetër të bregut të Drinit, për të vazhduar pastaj nëpër Mëshkallë, Gajtan, deri në Shkodër.<sup>66</sup> “Në vitet 1967-1970, në kodrën e Sardës u kryen gërmime arkeologjike nën drejtimin e arkeologëve H. Spahiu dhe D. Komata, nëpërmjet të cilave hoqën muret rrethuese dhe u zbuluan një sërë ndërtesash brenda tyre”.<sup>67</sup> Tek rrënojat dallohen akoma mbetjet e kullave katërkëndëshe mbi muret rrethuese të qytetit, portën e qytetit dhe rrënoja kishash, dhe të gjitha këto janë punime të thata d.m.th. pa asnjë

<sup>63</sup> *Acta et Diplomata res Albaniae Mediae Aetatis illustrantia*. Collegerunt et digesserunt Dr. Ludovigus de Thallóczy, Dr. Constantinus Jireček ed Dr. Emllianus de Sufflay. Volumen I (Annos 344-1343 tabelamque geographicam continens) Vindobonae MXMXVIII. Typis Adophi Holzhausen, dok. nr. 42, f. 9.

<sup>64</sup> K. Jireček, “Skutari und sein ...”, f. 116, *Krh. edhe Gjerak Karaiskaj*, “Qyteti shqiptar i Sardës. Origjina dhe zhvillimi i qytetit mesjetar në Shqipërinë e veriut”, në *Monumente*, Tiranë: nr. 1978, f. 75.

<sup>65</sup> Mbi vendndodhjen e Sardës krahaso edhe A. Theiner në “*Monumenta Slavorum II*, 219” “[...] sulla cima del monte format dal fiume Drino in forma d’una penisula tra monti di Drivasto e Polato; v’e apresso il colle colle muraglie rovinate della citta di Dagno”. L. Thallóczy, C. Jireček, E. Sufflay, *Acta et Diplomata res Albaniae ...*, I, dok. nr. 42, f. 9.

<sup>66</sup> H. Spahiu, D. Komata, “Shurdhahu...”, f. 257.

<sup>67</sup> Gj. Karaiskaj, “Qyteti shqiptar i Sardës...”, f. 75.

lloj ornamenti të gdhendur, apo skulptura.<sup>68</sup> Këto punime duhet të kenë qenë edhe më primitive se ato të Shasit.<sup>69</sup> “Gurët e mureve rrethuese në përgjithësi nuk kanë trajta të rregullta dhe në vendosjen e tyre nuk ndiqet ndonjë kriter i caktuar. Muratura e dy faqeve nuk është e rrafshët. Fugaturat midis gurëve janë mbushur me një llaç të dobët, përqindja e rërës në përbërjen e të cilit është më e madhe se ajo e gëlqeres dhe e zhavorrit.”<sup>70</sup> Sipas rezultateve të nxjerra nga gërmimet periudhat e ndërtimeve në Sardë mund t’i caktojmë si më poshtë:

**Periudha Ilire**, nga e cila duket se e ka origjinën qyteti, sepse ai duket se ka qenë dikur një kështjellë ilire dhe pas pushtimit romak kjo kështjellë u zhvillua në qytet.<sup>71</sup> Periudha ilire vërehet veçanërisht në cokolaturat e mureve rrethuese dhe të kullave, ku janë përdorur gjerësisht blloqe të përmasave të mëdha: 0, 73 × 0, 45 × 0, 77 m; 0,40 × 0, 20 × 0, 90 m. tipike për muret e kalave të hershme ilire.<sup>72</sup>

**Periudha e Antikitetit të vonë dhe e Mesjetës së Hershme**, ku Sarda datohet si kështjellë rreth shek. IV pas Kr. Nga ajo periudhë kanë mbetur pjesë nga muret rrethuese si dhe një kullë në formë U-je.<sup>73</sup> Sipas Spahiut dhe Komatës, të cilët bazohen në të dhënat arkeologjike, në këtë periudhë, pra në kufirin midis Antikitetit dhe Mesjetës së Hershme, duhet të kërkohej edhe fillimet e jetës në vendbanimin e Sardës.<sup>74</sup>

Në kullën në formë U-je, gjatë gërmimeve që u bënë, janë gjetur skelete njerëzish<sup>75</sup>, gjurmë të një masakre të shkaktuar nga sulmet e sllavëve dhe të avarëve në shek. VI. Nga këto sulme dhe vërshime u pushtua edhe Lezha dhe u shkatërrua kështjella e Sardës.<sup>76</sup> Megjithatë, edhe pse kështjella u shkatërrua papa Gregor I e përmend Feliksin

<sup>68</sup> K. Jireček, “Skutari und sein ...”, f. 116; Theodor Ippen, *Shqipëria e Vjetër*. Studime gjeografike, etnografike, historike nga ish-konsulli i përgjithshëm i monarkisë austro-hungareze në Shkodër. Përkthyer nga origjinalet: Gjerak Karaiskaj, Ardian Klosi. Me riprodhimin e fotografimeve dhe skicave origjinale të Ippenit, Tiranë: “K&B” 2002, f. 242.

<sup>69</sup> *Po aty*, f. 242.

<sup>70</sup> H. Spahiu, D. Komata, “Shurdhahu...”, f. 289.

<sup>71</sup> M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens...*, f. 26.

<sup>72</sup> H. Spahiu, D. Komata, “Shurdhahu...”, f. 289.

<sup>73</sup> Gj. Karaiskaj, “Qyteti shqiptar i Sardës...”, f. 75.

<sup>74</sup> H. Spahiu, D. Komata, “Shurdhahu...”, f. 311.

<sup>75</sup> *Po aty*, f. 268.

<sup>76</sup> Gj. Karaiskaj, “Qyteti shqiptar i Sardës...”, f. 75-76.

ipeshkvin e Sardës, në një dokument të vitit 594 (muaji tetor), dhe e urdhëron atë që t'i bindet ipeshkvit Johan të *Justiniana Pirma*.<sup>77</sup> Pas këtij pushtimi avaro-sllav qyteti që mbeti, është fare i panjohur dhe nga kjo kohë është zbuluar vetëm nekropoli i tij, "që sipas traditës së antikitetit të vonë shtrihej jashtë zonës së banuar ashtu siç e takojmë edhe në kalanë e Krujës në periudhën e hershme mesjetare."<sup>78</sup>

Në periudhën e Mesjetës së Mesme, zhvillimi i qytetit pati një goditje të rëndë kur ai u pushtua nga serbët në vitin 1185, pushtim ky që shkaktoi dobësimin e vazhdueshëm të Sardës deri sa u shua, kështu që në shek. XIV nuk mund të flitet më për qytetin e Sardës.<sup>79</sup> Në lidhje me pushtimet serbe, ndër kështjellat e pushtuara nga Nemanja, i biri i tij Stefani, "I kurorëzuari i parë" përmend ndërmjet Drishtit dhe Dejës edhe një kështjellë me emrin "Sardonikij"; pa dyshim se kjo duhet të lexohet si "grad Sardon(s)kij" (pra, forma mbiemër e Sardës). Stefan Nemanja e pushtoi Sardën dhe ky pushtim çoi në ndërprerjen e strukturës politike duke instaluar një vojvodë që çoi në ndarjen e qytetit në pjesë administrative-ushtarake dhe në pjesë civile.<sup>80</sup> Pjesa administrative ushtarake u veçua me mure dhe nga gërmimet arkeologjike del se kishte një sipërfaqe prej 1, 5 ha.<sup>81</sup>

Në periudhën e Mesjetës së Mesme u rindërtuan muret rrethuese me gjerësi 70-90 cm, duke u mbështetur tek ato të antikitetit të vonë që kishin një gjerësi dyfish më të trashë. Bile dhe kulla në formë U-je u përfshi brenda një kulle mesjetare që u ndërtua po në atë formë.<sup>82</sup>

Në pjesën e sipërme të qytetit kishte një portë ku fillonte një rrugë e drejtë që vazhdonte në drejtim të Jugut, dhe mesa duket kjo rrugë ishte pjesë e një rrjeti rrugor që kishte ekzistuar edhe në antikitetin e vonë duke vazhduar kështu edhe në Mesjetën e Hershme.<sup>83</sup> Për rrugët, në përgjithësi mund të thuhet se nuk kishin një rrjet të rregullt, dhe se qyteti nuk kishte

<sup>77</sup> "(594) mense octobri. Gregorius I. papa Felicem Episcopum Sardicensem Johanni, primae Justinianae episcopo parere iubet." L. Thallóczy, C. Jireček, E. Sufflay, *Acta et Diplomata res Albaniae ...*, Dok. Nr. 42, f. 9.

<sup>78</sup> Gj. Karaiskaj, "Qyteti shqiptar i Sardës...", f. 75.

<sup>79</sup> M. Šufflay, *Städte und Burgen Albaniens...*, f. 26.

<sup>80</sup> Gj. Karaiskaj, "Qyteti shqiptar i Sardës...", f. 77.

<sup>81</sup> Po aty.

<sup>82</sup> Po aty, f. 75-76.

<sup>83</sup> Po aty, f. 76.

shesh, përveç hapësirave përreth kishave që shërbenin si vende varrimi.<sup>84</sup> Përsa i përket varreve dhe varrezave në Sardë në qytetin e poshtëm janë gjetur gjithsej 11 varre, dhjetë janë individuale dhe një është kolektiv,<sup>85</sup> kurse një varrezë u gjet jashtë mureve rrethuese të qytetit pranë një kisha, varrezë kjo e përbërë nga gjashtë varre, që dy janë kolektivë dhe katër janë individualë.<sup>86</sup> Varrimi bëhej, ose përreth kishave siç do të përmendet edhe më poshtë dhe kjo ishte shenjë e besimit të vendasve, ose pranë mureve rrethuese, por brenda tyre dhe kjo duket se është tipike sidomos gjatë kohërave, kur qytetet janë të rrethuara.<sup>87</sup>

Banesat, mbeturinat e të cilave janë gjetur nga gërmimet, i përkasin shekujve X-XI. Ato janë të ndërtuara me mure guri, të lidhura me llaç dhe të mbuluara me rrasa guri.<sup>88</sup> Sipas Karaiskaj, banesat e Sardës, nëse i krahasojmë me ato të një qyteti të vogël bizantin të kohës së atëhershme, janë më të mëdha dhe pjesa më e madhe janë me dy kthina në katin përdhes, kurse banesat njëkthinëshe aty janë të rralla.<sup>89</sup> Hyrjet e këtyre banesave nuk komunikojnë drejtpërdrejtë me rrugën, por nëpërmjet një rrugice më të ngushtë anësore.<sup>90</sup> Por, përveç këtij tipi banesë në Sardë janë gjetur edhe banesa më të vogla njëkthinëshe, të cilat në ndryshim me të parat komunikojnë drejtpërdrejtë me rrugën kryesore.<sup>91</sup>

Banesat në kodrën e qytetit kanë qenë shumë të dendura dhe të grupuara së bashku, bile shumë prej tyre të ngjitura me njëra-tjetrën.<sup>92</sup> Ato, mesa duket nga gërmimet arkeologjike, nuk kishin as oxhak, dhe as ambiente sanitare, përveç një banese dykthinëshe që u gjet në murin rrethues të sipërm, e cila në pjesën e prapme të korridorit të saj kishte një ndarje me mur. Kjo supozohet se ishte kthinë sanitare.<sup>93</sup>

Në lidhje me tipin e qytetit, ku Sarda bën pjesë, mund të thuhet që ajo në përgjithësi nuk e ka vulën bizantine, pasi mungon arkiopoli, por gjurmët bizantine shihen tek ndonjë shtëpi njëkthinëshe, apo tek

<sup>84</sup> Po aty, f. 77.

<sup>85</sup> H. Spahiu, D. Komata, "Shurdhahu...", f. 291-94.

<sup>86</sup> Po aty, f. 306-308.

<sup>87</sup> Po aty, f. 294.

<sup>88</sup> Gj. Karaiskaj, "Qyteti shqiptar i Sardës...", f. 77.

<sup>89</sup> Po aty.

<sup>90</sup> Po aty.

<sup>91</sup> Po aty.

<sup>92</sup> Po aty.

<sup>93</sup> Po aty.

ekzistenca e varreve përreth kishave,<sup>94</sup> por vetë kishat duhet të kenë qenë më tepër të stilit dalmat jugorë më prejardhje nga Italia, ngaqë në to shihen ndikime romaniko-gotike, sidomos tek portat dhe dritaret, ku vihen re gjurmë të harqeve të varura, të ashtuquajtura “Lombarde” dhe harqeve të verbër.<sup>95</sup> Por, kjo tipologji qyteti pavarësisht se e afron Sardën më afër perëndimit, duhet të thuhet që ka një ndryshim të madh me qytetet perëndimore mesjetare, ngaqë mungon një shesh qendror me një kishë të madhe në mes.<sup>96</sup>

Tani në lidhje me zejet mund të thuhet, që Sarda nga numri i madh i objekteve të gjetura në këtë qytet supozohet të ketë pasur edhe punishte metalesh (kovaçhana). Këto supozime i mbështesin sidomos sendet e gjetura pranë një muri me drejtim veri-jug, të cilat ishin me shumicë dhe përbëheshin nga objekte të tilla si stoli, vegla pune, armë dhe mbeturina të ngjyrës së hekurit.<sup>97</sup> Po ashtu në qytet duket se është njohur mirë edhe punimi i poçerisë, pasi aty u gjet një sasi e madhe objektesh qeramike, si enë shtëpiake të përdorimit të përditshëm kryesisht, dhe në masë shumë më të vogël materiale ndërtimi (tulla e tjegulla).<sup>98</sup> Qyteti i Sardës u shkatërrua nga pushtimi turk në vitin 1491 dhe pas këtij shkatërrimi nuk u rimëkëmb kurrë më.<sup>99</sup>

### Sarda si qendër kishtare dhe Ipeshkvi

Sipas gojëdhënave popullore Sarda kishte aq shumë kisha sa ka ditë viti,<sup>100</sup> dhe kjo na kujton gojëdhënat në lidhje me numrin e kishave të Shasit në afërsi të Shkodrës dhe të Voskopojës në afërsi të Korçës, pasi edhe për to thuhet e njëjta gjë. Sipas një relacioni të Frang Bardhit qyteti kishte pasur dikur 80 kisha.<sup>101</sup> Sipas të dhënave të tjera, Sarda quhej edhe “*Ishulli i njëqind altarëve*”<sup>102</sup>. Këtu mund të përmendim Kishën e Shën

<sup>94</sup> Po aty, f. 79.

<sup>95</sup> Po aty.

<sup>96</sup> Po aty.

<sup>97</sup> H. Spahiu, D. Komata, “Shurdhahu...”, f. 279.

<sup>98</sup> Po aty, f. 294.

<sup>99</sup> Po aty, f. 313.

<sup>100</sup> Po aty, f. 287.

<sup>101</sup> T. Çobani, *Frang Bardhi dhe Relacionet...*, f. 120.

<sup>102</sup> *Shurdhah*. Tesi di Laura Facolta. di Architettura Politecnico di Bari. URL:

[http://architettura.poliba.it/ricerca/tesi-di-laurea/aa\\_2006\\_2007/shurdhah-albania](http://architettura.poliba.it/ricerca/tesi-di-laurea/aa_2006_2007/shurdhah-albania)  
(12. 7. 2011)

Mërisë së Ngjitun në Qiell, kishë kjo e moçme porse e rindërtuar dhe e mbuluar me tjegulla në kohërat e Frang Bardhit.<sup>103</sup>




Fig.7. Rikonstrukcion i Kishës (A) e Sardës.

Sipas, Spahiut dhe Komatës, brenda mureve të çështjellës, nga gërmimet e viteve 1967-70 janë konstatuar dhjetë objekte kulti,<sup>104</sup> ndër to shtatë kisha, nga të cilat më e rëndësishmja për t'u përmendur, sipas Karaiskajt, është ajo pranë hyrjes kryesore, e cila mesa duket ishte pjesë e një manastiri të vogël, pasi pranë saj është zbuluar edhe një banesë me pesë kthina që së bashku me kishën ishin të rrethuara me mur, pra ishin pjesë të një kompleksi.<sup>105</sup> “Kisha është njënefshe, me narteks dhe absidë gjysmë rrethore që sot nuk ruhet, në dyshemenë e narteksit janë hapur varre, ku duket se janë varrosur dinjitarë fetarë.”<sup>106</sup> Kjo kishë ishte e mbuluar me tjegulla ndryshe nga ndërtesat e tjera të qytetit që ishin të mbuluara me rrasa guri.<sup>107</sup>

Jashtë mureve të qytetit, që mesa duket kishin kufizuar jo vetëm qytetin antik, por edhe atë mesjetar ndodhet një zonë me mbetje kishash, nga të cilat dy prej tyre ishin krejt afër mureve, kurse një e tretë ndodhet rreth 300 m larg dhe mesa duket shërbente si kishë varresh.<sup>108</sup>

Qyteti i Sardës si ipeshkëvi i përkiste Arqipeshkëvisë së Tivarit (Antivarit).<sup>109</sup> Sipas Shuflajt ky qytet ishte selia e Arqipeshkëvit të Pultit

<sup>103</sup> T. Çobani, *Frang Bardhi dhe Relacionet...*, f. 120.

<sup>104</sup> H. Spahiu, D. Komata, “Shurdhahu...”, f. 287.

<sup>105</sup> Gj. Karaiskaj, “Qyteti shqiptar i Sardës...”, f. 76-77.

<sup>106</sup> Po aty, f. 76.

<sup>107</sup> Po aty, f. 77.

<sup>108</sup> Po aty, f. 76.

<sup>109</sup> K. Jireček, “Skutari und sein ...”, f. 116.

(*Polatum Minor*), dioqezë kjo që mbijetoi si titull “*Polatensis Minor*) edhe pas shuarjes së qytetit. Si qendër ipeshkvnore Sarda njihet aty nga fundi i shek. XII.<sup>110</sup> (Fig. 7. Rikonstruksion i Kishës (A) e Sardës. I bërë nga “*Facolta di Architettura Politecnico di Bari, Itali*”).<sup>111</sup>) Përsa i përket të dhënave që na sjell Frang Bardhi në relacionin e tij të 10 prill 1641, në të cilin thuhet, se aty ndoshta është zhvilluar Koncili Sardicens në vitin e Krishtit 347, në të cilin morën pjesë 370 ipeshkvij (për këtë koncil flet edhe kardinali Cesare Baroni në analet e veta ekleziastike)<sup>112</sup>. Por sipas Zamputit, “*Asht fjala për kardinalin Cezar Baronio (1538-1607) nga Sora e Laciumit t’Italisë. Baronio shkroi Analet ekleziastike, që asht një histori e kishës deri më 1198. Por sikurse lajmi për gallogrekët i marrun nga Barleti, si edhe interpretimi që Frang Bardhi i ban Baronio-s tue identifikue qytetin Sardica, ku u zhvillue koncili me Sardën tonë (Shurdhatën ose Shurdhahun), duhen marrë me rezervë*”.<sup>113</sup>

Peshkopët e Sardës (*episcopi Sardenses* apo *Sardanenses*) përmenden nga viti 1190 deri në vitin 1460 dhe janë shtatëmbëdhjetë gjithsej<sup>114</sup>; porse Kisha e Sardës (*ecclesia Sardanensis*) në vitin 1290 cilësohej si “*inter nationes perverses posita*” (pra e vendosur midis njerëzish [paganë] e të këqij – E. M.). Nganjëherë këta peshkopë mbajnë edhe titullin e ipeshkvit të “*Polatum Minus*” (Pultit të Vogël), krahinë e vogël kjo që gjendet tek një mal aty afër, por që më vonë iu bashkua Ipeshkvisë së Sapës.<sup>115</sup>

Sarda duhet të ketë bërë pjesë në territoret e Dukagjinëve, po t’u referohemi ndarjeve mesjetare territoriale, por ajo mund të ketë qenë edhe pronë e Zakariajve, të cilët ishin fqinjë me Dukagjinët.<sup>116</sup> Në vitin 1491, pas pushtimit të vendit nga osmanët, Dioqeza e Sardës u bashkua

<sup>110</sup> D. Farlati, *Illyricum Sacrum*, 7, f. 273.

<sup>111</sup> Fig. 6. Rikostruksion i Kishës (A) të Sardës i bërë nga “*Facolta di Architettura Politecnico di Bari, Itali*”. *Shurdhah*. Tesi di Laura Facolta, *bur. i përm.*

<sup>112</sup> “*Relacioni i Frang Bardhit më 10 prill 1641*”, në *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në Shekullin XVII*. Teksti origjinal dhe përkthimi përgatitur nga Injac Zamputi, Vëll. II (1610-1934), Tiranë: Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1963, f. 199.

<sup>113</sup> *Po aty*, f. 465, dokum. Nr. 35, shënim 9.

<sup>114</sup> Th. Ippen, *Shqipëria e Vjetër...*, f. 242.

<sup>115</sup> K. Jireček, “*Skutari und sein ...*”, f. 116.

<sup>116</sup> Th. Ippen, *Shqipëria e Vjetër...*, f. 242.

me atë të Sapës,<sup>117</sup> dhe më poshtë për të dhënë një panoramë më të plotë të ipeshkëvisë së Sardës, po japim edhe vargun e ipeshkëve të saj.

### Vargu i ipeshkëve të Sardës deri në 1521

1190. Anonim (*N.N Episcops Sardensis I.*) Në vitin 1190 përmendet për të parën herë një ipeshkëv i Sardës në një burim me titull "*Shënime mbi kishat në kohën e Celestinit III*" (*Notitia Ecclesiarum tempore Caelestini III*) dhe në këto shënime thuhet që "Ipeshkvi i Tivarit ka si sufraganë Ulqinin, Drishtin Pultin, Shkodrën, Krujën dhe Sardën"<sup>118</sup> Ky është pra shënimi që e bën të njohur për herë të parë ekzistencën e Ipeshkvisë së Sardës, por pa dhënë emrin e ipeshkvit dhe pas kësaj të dhëne Kisha dhe Ipeshkvi i Sardës (*Ecclesia & Episcopus Sardensis vel Sardanensis*) përmendet në çdo katalog të provincave, duke e cilësuar atë si provincë të Tivarit.<sup>119</sup>

1192. Teodori, Ipeshkëv i Sardës (*Theodori. Episcopus Sardensis II*)

I dyti ipeshkëv i Sardës është Teodori. Një e dhënë mbi të është një nënshkrim i tij si pjesëmarrës në Koncilin Diokletan. Nënshkrimi ka përmbajtjen si më poshtë: Unë, Teodori Ipeshkvi i Sardës, nënshkrova. (*Ego, Theodorus Savanen, id est, Sardanen. Episcopus subscripsi*).<sup>120</sup>

1260. Anonim (*N. N Episcops Sardensis III*). Për rreth 50 vjet nuk kemi asnjë të dhënë në lidhje me kishën dhe ipeshkvit e Sardës. Pas Teodorit ipeshkvijtë e Sardës nuk janë të njohur dhe në vitin 1260 bëhet fjalë për një ipeshkëv të vdekur të Sardës i cili u zëvendësua po atë vit nga Pjetri.

1266. Pjetri, Ipeshkëv i Sardës (*Petrus Episcopus Sardensis IV*)

Pjetri ishte i kombësisë italiane dhe i përkiste urdhrit Françeskan. Ipeshkvinë e Sardës ja dha atij Laurenti, Arqipeshkvi i Tivarit me mandat të papë Aleksandrit IV.<sup>121</sup> Pjetri ishte një klerik i formuar mirë dhe e

<sup>117</sup> Po aty.

<sup>118</sup> "*Episkopus Antibarensis has habet Sufragganeos Dulchinensem, Drivastensem, Polatensem, Scodrinensem, Albanensem, Sardensem*". D. Farlati, *Illyricum Sacrum* 7, f. 273.

<sup>119</sup> Po aty.

<sup>120</sup> Po aty.

<sup>121</sup> G. Valentini, *Kontribute në kronologjinë...*, f. 95. Dokumenti: *Regeste Vaticana ... 25. Nr. 252v. Shih edhe: D. Farlati, Illyricum Sacrum* 7, f. 273.

mbajti këtë ipeshkvi deri në vitin 1276, ndoshta deri më 1278, vit në të cilin vdes.<sup>122</sup>

1278. Ptolemeu, Ipeshkëv i Sardës (*Ptolemeus Episcopus Sardensis V*)

Ptolemeus ishte një murg eremit i Shën Ausanit.<sup>123</sup> Ai përmendet si ipeshkëv i Sardës në vitin 1278 në një gjenealogji të Habsburgasve. ai qëndroi në këtë ipeshkvi deri në vitin 1286 dhe prej aty me urdhër të papës Honorius IV u transferua në kishën e Ravellas. Emri i tij në cilësinë e ipeshkvit të Sardës del edhe në një diplomë të vitit 1284, në të cilën bëhet fjalë për dënimin për disa çështje kriminale që i bëhet një kishe mbi ishullin Bodon (*insula Bodonis Mindensis*) në Dinastinë Mindense (!) që në popull quhej ndryshe edhe Bodenwerder. Ptolemeus së bashku me disa ipeshkvij të tjerë merr pjesë në marrjen e vendimit.<sup>124</sup>

1291. Anonim (*N. N Episcops Sardensis VI*). Sipas Farlatit kanonikët e Kishës së Sardës donin të zgjidhnin Tanushin që ishte arkipresbiter i Kishës së Dioklesë si ipeshkëv të Sardës, por kjo zgjedhje nuk pati efekt, pasi mesa duket që bërë sipas ligjit kanonik të paracaktuar, apo për shkak se neglizhoi të kërkojë në kohën e duhur aprovimin nga Selia. Gjithsesi nuk janë të qarta shkaqet se pse ai nuk u bë ipeshkëv.<sup>125</sup> 1. 3. 1291 Papa Nikolla IV e porosit arqipeshkvin e Tivarit të bëjë ipeshkëv të Sardës një françeskan prej Raguze.<sup>126</sup> Ipeshkvit që u zgjodh nuk i dihet as emri.

Për shumë dhjetëvjeçarë me rralë nuk përmendet ndonjë ipeshkëv i Sardës, deri në vitin 1372. Në këtë vit kemi një të dhënë nga "Libri i detyrimeve i Dhomës Apostolike, në të cilin thuhet se: "për vitin 1372 në Provincën e Tivarit i detyrohet të dhjetën Selisë Apostolike arqipeshkvi i Tivarit, dhe ipeshkvijtë e Ulqinit, ... Sardës, Shkodrës, dhe që prej kësaj të dhjete nuk është marrë dhe nuk është përcaktuar asgjë, pasi ata janë të varfër dhe jetojnë në skamje."<sup>127</sup> Pra, siç shihet edhe më lart ipeshkvi i Sardës përmendet por nuk dihet emri i tij.

<sup>122</sup> Po aty.

<sup>123</sup> Po aty, f. 273-274.

<sup>124</sup> Po aty, f. 274.

<sup>125</sup> Po aty.

<sup>126</sup> G. Valentini, *Kontribute në kronologjinë...*, f. 96. Dokumenti: *Regeste Vaticana .... 25. Nr. 13v.*

<sup>127</sup> "Anno 1372. in provincia Antibarensi debeant decimas Sedi Apostolice Archiep. Antibaren. & Episcopi Dulcinen. ... Sarden. Scutaren. de quibus nihil receptum fuit, neque exactum; pauperes sunt, et in miseria vivunt." *Ex libr. Oblig. Cam. Apost. D. Farlati, Illyricum Sacrum 7, f. 274.*

1381. Jakobi, Ipeškëv i Sardës (*Jakobus, Episcopus Sardensis VII*) Jakobi ishte i urdhrit eremit agustinian dhe mbiemri i tij ishte *de Burgo*. Para se të vinte në Sardë kishte shërbyer në Itali, në ipeshkvinë Tifarnas(!).<sup>128</sup>

1386. Peregrini, Ipeškëv i Sardës (*Peregrinus Episcopus Sardensis VIII*) ishte i urdhrit benediktin dhe abat i kishës Shën Sofisë në Zento. Koha e tij si ipeshkëv ishte e shkurtër dhe si rrjedhojë nga viti 1386 deri në vitin 1392 konstatohen në të vërtetë edhe tre emërime të tjera si ipeshkvij të Sardës në regjistrat e Vatikanit, por që Farlati ua përmend emrat si më poshtë.

1386 (i pasigurt) Antoni I. dhe Antoni II. (*Antonius I. et Antonius II Episcopi Sardensis IX et X*). Këta megjithatë nuk janë të sigurt, dhe mbase ngatërrohen për Antonin III që pason më poshtë.<sup>129</sup>

1392. Antoni III, Ipeškëv i Sardës (*Antonius III Episcopi Sardensis XI*). Ai u zgjodh ipeshkëv i Sardës në vitin 1392.<sup>130</sup> Në vitin 1394, gjatë kohës kur ky ipeshkëv ishte akoma në pushtet, Ipeškvia e Sardës, e cila kërcënohej të zhdukej u vu nën mbrojtjen venedikase.<sup>131</sup> Kjo ndodhi pasi në postin e arqipeshkvit të Durrësit, nga kapiteli i kësaj arqipeshkëvie u zgjodh një klerik që mbante krahun e Venedikut.<sup>132</sup> Sipas Farlatit Antoni III qëndroi si ipeshkëv i Sardës deri në vitin 1395.<sup>133</sup>

1395. Mariani, Ipeškëv i Sardës (*Marianus Episcopus Sardensis XII*) Mariani e kishte mbiemrin Genci, dhe ishte nga Reatina. Ai bëhet ipeshkëv, sepse vdes Antoni III. Mariani e mban këtë titull për shtat vjet, deri më 1402.<sup>134</sup>

1402 Andrea, ipeshkëv i Sardës (*Andreas Episcopus Sardensis XIII*). Andrea ishte abat i kishës së Shën Sofisë në Zenta. Siç e përmendëm edhe më lart, ai ishte edhe ipeshkëv i Dejës, dhe në këto ofiqe ai qëndron

<sup>128</sup> *Po aty.*

<sup>129</sup> "Brevem ejus Episcopatum fuisse ex eo constat, quod ab anno 1386. ad annum 1392. tres Episcopi Sardenses in tabulis Vaticanis nominantur; nimirum".  
*Po aty*, f. 275.

<sup>130</sup> *Po aty.*

<sup>131</sup> O. Schmitt, *Das venezianische Albanien...*, f. 572.

<sup>132</sup> *Po aty.*

<sup>133</sup> D. Farlati, *Illyricum Sacrum* 7, f. 275.

<sup>134</sup> *Po aty.*

deri në vitin 1411, për t'u caktuar pastaj si ipeshkëv i Krujës (*Episcopus Albanensis*).<sup>135</sup>

1412. Gjoni, Ipeshkëv i Sardës (*Joannes Episcopus Sardensis XIV*). Ai ka qenë presbiter i Kishës së Sardës dhe mbiemri i tij ishte Pëllumbi (Palumbis). Atë e bëri ipeshkëv papa Gjoni XXIII, si rrjedhojë e transferimit të Andreas në Krujë, apo ndryshe e quajtur edhe si "Kisha e Arbërit".<sup>136</sup>

1428. Pjetër Matias, Ipeshkëv i Sardës (*Petrus Matthias Episcopus Sardensis XV*). Pjetri ishte kanonik i Kishës së Sardës, dhe siç e përmendëm edhe më lart tek ipeshkvijtë e Dejës, ipeshkvia e Sardës në këtë kohë ishte bashkuar me atë të Dejës nga papa Martini V, dhe pikërisht ishte ky papë që e titullon Pjetrin ipeshkëv, pasi Sarda kishte vite që ipeshkvia e saj ishte vakante.<sup>137</sup>

1444 Shtjefni, Ipeshkëv i Sardës (*Stephanus Episcopus Sardensis XVI*). Siç e përmendëm edhe më sipër te arqipeshkvinjtë e Dejës, ky është Shtjefni i fisit të Dukagjinit, që kishte qenë arqidiakon i Kishës së Shkodrës (*Ecclesia Scodrensis*). Kur turqit po kërcënonin Shqipërinë papa Eugjeni IV më 6 qershor të vitit 1444 e bën Shtjefnin ipeshkëv të Dejës dhe të Sardës.<sup>138</sup>

1460. Jakobi II, ipeshkëv i Sardës (*Jacobus II Episcopus Sardensis XVII*). Jakobi është ipeshkvi i fundit i saj pasi më vonë, kjo ipeshkvi së bashku me atë të Dejës dhe të Sapës, shkrihen në një duke formuar kështu Ipeshkvinë e Sapës.<sup>139</sup>

Në lidhje me shkrirjen e këtyre ipeshkëvive nga tre në një të vetme, mendoj që shkak ishte pushtuesi turk që çoi jo vetëm në zvogëlimin e numrit të popullsisë por edhe në bërjen shkrumb e hi të këtyre qyteteve.

Kaq pra mund të thuhet për Dejën dhe Sardën, të cilat sot janë gërmadha, por që dikur patën një zhvillim të konsiderueshëm për derisa ishin edhe qendra ipeshkvnore.

<sup>135</sup> Po aty.

<sup>136</sup> "Anno 1412. IV. Idus Februarii; provisum est Ecclesiae Sardensi in provincia Antibarensi vacanti per translationem Andrae olim Episcopi dicte Ecclesiae ad Ecclesiam Arbanensem de persona Johannis de Palumbis dioecesis Sardensis". Po aty.

<sup>137</sup> Po aty.

<sup>138</sup> Po aty, f. 232.

<sup>139</sup> Po aty, f. 275.

*S u m m a r y*

## THE TOWNS OF DEJË AND SARDË AND THEIR BISHOPRICS IN THE MIDDLE AGES

The aim of this article is to provide a short overview of the medieval history of Dejë and Sardë, two towns that were situated in the vicinity of Shkodra and used to be real urban centers composed of all the elements of medieval towns, and that now do not exist anymore.

At present, in these two locations there have remained only ruins that have been subject to different robberies and are covered by wild plants. There is no road to take you to these sites, thus, they are not easily accessible by visitors. In addition, Dejë is situated on a mountain top which makes it even more difficult to get there. Whilst, Sardë is situated amongst the waters of Drin, inside the Vau Dejës Lake and without a boat it is impossible to visit it. These towns used to have an admirable development of crafts, economy and culture. Moreover, in Dejë there used to be a customs house as this town was situated at the crossroad between Shkoder and Lezhë and from there one could get to Prizren. As a result, it was used as a transit site for goods and people, a fact that certainly influenced in the development of the town.

These two towns throughout the mid and late Middle Ages were also bishoprics and had a lot of churches. That is why, apart from giving a general overview, this paper aims at introducing the history of these bishoprics, making thus a modest contribution to the history of Albanian Catholic Church in the Middle Ages. In order to achieve this aim I have mainly consulted the work of Daniele Farlati "Illyricum Sacrum 7".